



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr.03-64**  
**16.04.2023**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit të njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar ark.nr.01-4139 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-460/1 datë 27.01.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-735/4 datë 15.2.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 5-të mbajtur më 15.2.2023, miratoi:

**Aktvendim**  
**për ndërmarrje të masës – vërejtje publike**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) DIBRA TV SHPKNJP Dibër, për shkeljen e kryer të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 16 janar 2023, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, si dhe as së paku gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, të transmetuara në periudhën prej orës 7:00 deri në orën 19:00.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-460/1 datë 27.1.2023, si pjesë përbërëse i këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR DIBRA TV SHPKNJP, Dibër që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e vërtetimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

**A r s y e t i m**

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente të kryej mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave nga ligji i cituar, lejet, vërtetimet e dhëna për regjistrimit, aktet nënligjore dhe aktet tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masën - aktvendim për vërejtje publike në rastet kur ka cenim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pikën 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, përcaktohet se për shkeljet e konstatuara në vitin aktual, për të cilat janë shqiptuar masa në vitin paraprak, Këshilli i Agjencia sërish do të shqiptojë masë vërejtje publike sipas afateve të përcaktuara në Udhëzim.

Në bazë të nenit 92 paragrafi (1) dhe (3) të LSHMAAV, Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbime programore televizive janë të detyruara të transmetojnë së paku 30% të programeve të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuele maqedonase, ndërsa shërbimi transmetues publik së paku 40%. Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbime programore televizive janë të detyruara të përmbushin së paku gjysmën e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni t'i realizojnë në periudhën prej orës 07:00 deri në ora 19:00.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia, nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 27 janar 2023, ka kryer mbikëqyrje të kontrollit programor (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër, transmetuar më 16 janar 2023, në nivel lokal, ku konstatoi se transmetuesi nuk ka vepruar sipas aktvendimit për shqiptimin e masës – vërejtje publike PA1 03-357 datë 29.11.2022, gjegjësisht nuk ka mënjanuar shkeljen e kryer të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Gjegjësisht, me mbikëqyrje u konstatua se më 16 janar 2023, shërbimi programor televiziv i SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër, ka transmetuar 3 orë 22 minuta e 2 sekonda programi të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që është 14.07% e totalit të programit të transmetuar gjatë ditës që përfshihet në llogaritjen për program të krijuar burimor (23 orë 56 minuta e 16 sekonda). Minimumi ligjor prej 30% për transmetim të programi të krijuar burimor gjatë një dite, në raport me totalin e programit të transmetuar më 16 janar 2023 që hyn në llogaritjen për program të krijuar burimor (23 : 56 : 16), është 7 orë 10 minuta dhe 52 sekonda. SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër transmetoi për 3 orë 48 minuta e 50 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase. Gjysma e minimumit ligjor (nga 07 : 10 : 52) është 3 orë 35 minuta e 26 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që më së pakti duhej të transmetohej në programin e SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër në periudhën prej orës 7:00 deri në orën 19:00. Gjatë kësaj periudhe, siç konstatohet nga mbikëqyrja, janë transmetuar 2 orë 36 minuta e 35 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që në këtë situatë është 58 minuta dhe 51 sekonda më pak se minimumi i kërkuar.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-460/1 datë 27.1.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në bazë të nenit 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër më datë 30.1.2023, dërgoi Shkresë ark.nr.10-460/2 datë 30.1.2023, me të cilën ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-460/1 datë 27.1.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, t'i dorëzojë Këshillit të Agjencisë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 1.2.2023. Në afatin e paraparë, SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër nuk është deklaruar për shkeljen e kryer të ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën mbajtur më 15.2.2023, shqyrtoi Raportin me shkrim dhe konkludoi ndaj SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër duhet t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, bazuar në nenin 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Teksti i pastruar), Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e krye programore ark.nr.10-460/1 datë 27.1.2023, për shkak të konstatimit të mosrespektim të dispozitave të LSHMAAV, të përcaktuara në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 5-të mbajtur më 15.2.2023, në pajtim me Konkluzioni ark.nr.02-735/4 datë 15.2.2023, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër dhe detyrohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas vendimit.

Në bazë të nenit 24 paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afaat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

#### **Shtojcë (1):**

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-460/1 datë 27.1.2023.

**Agjencia për Shërbime  
Mediatike Audio dhe Audiovizuale,  
Kryetari i Këshillit,**

\_\_\_\_\_  
**Lazo PETRUSHEVSKI d.v**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

**Dorëzuar tek:**

- SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër;
- Drejtuesi i SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër;
- Personi përgjegjës i programit në SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër ;
- Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike;
- Sektori për çështje programore ; dhe
- Personat e emëruar në Agjencinë për udhëheqjen e regjistrit PA 1.